




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Në bazë të nenit 14 paragrafi 14.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 7 paragrafët (1)(2) dhe (3) të Ligjit për Dhënen në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtëshme të Komunës Ligji Nr.04/L-144, dhe në harmoni me nenin 21 paragrafi 21.2 të Statutit të Komunës së Deçanit, me propozimin e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.06.2018, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN ME QERA NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË ECO-TREGUT NË DEÇAN

I.

Me këtë Vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënie e pronës Komunale me qera në shfrytëzim afatshkurtër, për shfrytëzimin e kapaciteteve ekonomike, e cila gjendet në një pjesë të parcelës nr.pn-893, në rrugën Elez Geci-Maxhun Berisha” Çertifikata P-70505021-00893-0, me kulturë oborr shtëpi, Zona Kadastrale Deçan, me sipërfaqe që duhet të shfrytëzohet 700 m², e evidentuar si pronë komunale.

II.

Me dhënie e pronës komunale me qera në shfrytëzim afatshkurtër, do të realizohen dy interesa publike për Komunën e Deçanit, të ardhurat që realizohen nga dhënia në shfrytëzim (qeraja) dhe hapja e vendeve të reja të punës.

III.

Kohëzgjatja e dhënies në shfrytëzim është deri në 15 vite, dhe procesi i fitimit të drejtës së shfrytëzimit me qera për personat fizik dhe juridik do të fitohet nëpërmes ankandit publik.

IV.

Për procedurat e ekzekutimit të këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës sipas Rekomandimeve të Komisionit të ndërtuar nga Kuvendi i Komunës..


V.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.


01.Nr.VII-8/2

Deçan,dt.29.06.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj



Duke u bazuar në nenin 40.2 germa (i) të Ligjit për vetëqeverisje Lokale Nr.03\L-040, neni 25 pika 6 e Statutit të Komunës së Deçanit, në Ligjin për Sistemimin e Adresave në Republikën e Kosovës Nr.04\L071, me propozimin e Komisionit Komunal për Emërimin dhe Riemërimin e rrugëve, Shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Deçanit, si dhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.06.2018, mori këtë:

VENDIM

PËR EMËRIMIN DHE RIEMËRIMIN E SHESHEVE DHE RRUGËVE NË KOMUNËN E DEÇANIT

I

Aprovohet lista për emërimin dhe riemërimin e Sheshit dhe rrugëve në territorin e Komunës së Deçanit, sipas të dhënave të prezentuara në vijim:

- Në fshatin Prapaqan, emërohet rruga “Hazir Krasniqi”.
- Në fshatin Ratishë i Ulët emërohet rruga “Marash Krasniqi”.
- Rruga që lidhë fshatratë Pobergj-Hulaj emërohet “Musa Tolaj”.

SISTEMI I ADRESAVE NË KOSOVË LISTA E EMËRTIMEVE PËR RRUGËT NË KOMUNËN E DEÇANIT

PRAPAQAN

1.	“Hazir Krasniqi”	Rrugë e re
----	------------------	------------

RATISH I ULËT

1.	“ Marash Krasniqi”	Rrugë
----	--------------------	-------

POBERGJ-HULAJ

1.	“ Musa Tolaj”	I tërë segmenti
----	---------------	-----------------

II.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

III.

Vendimi u dërgohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë për Punë të Brendshme, Ministrisë për Planifikimin Hapësinor, Agjensionit Kadastral të Kosovës, Entit Statistikor të Kosovës, Drejtorive Komunale, Zyrës për informim, Kryetarit të Komunës dhe Arkivit të Komunës.

01.Nr.VII-5

Deçan,dt.29.06.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

	
KRYESUESI I KUVENDIT REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT - OPŠTINA DEČANO - DEÇAN MUNICIPALITY	
Nr. Prot: 01	Br. Prot: 19270
From: <u>K.K. Deçan</u>	Prot. No: <u>19270</u>
Nr. i faqeve: 01	Data: <u>04-07-18</u>
Br. Stranice: 01	Date: <u>04-07-20</u>
No. Pages:	
DEÇAN DEČANE	

Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Në bazë të Qarkores Buxhetore 2019/01 të Ministrisë për Financa të dt.15 Maj 2018, nenit 40.2(b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 , nenit 25 pika 2 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.06.2018, bie këtë:

V E N D I M

MBI APROVIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE PËR KOMUNËN E DEÇANIT PËR VITET 2019/2021

I.

Aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore për Komunën e Deçanit për vitet 2019-2021.

II.

Pjesë përbërse e këtij Vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore për Komunën e Deçanit për vitet 2019-2021.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen:MF-Departamenti i Buxhetit dhe Arhivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

01.Nr. VII- 3 ,

Deçan,dt.29.06.2018

		BALËNE-CLAZNA-OUTBORIS REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DECANI • DEÇAN MUNICIPALITY	
Mr. i Org.	K. Komula D.	Mr. Prot.	18613
Org. Jeshile		Mr. Prot.	
Org. Unit		Prot. Sh.	
Mr. i Faqes:	01	Dates:	29.6.18
Dr. Struktore:		Dates:	
Mr. Pages:		Dates:	
DEÇAN DECANI			




Kryesuesi:
Haki Shehaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Në bazë të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe nenit 47 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.06.2018, bjen këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

I.

Ndryshohet dhe plotësohet pika nr.I.7 e Vendimit të dt. 14.12.2017, për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa pranë Kuvendit të Komunës së Deçanit.

Natyra Kuçi, emrohet anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa në vend të Kastriot Lokaj, nga i njëjti subjekt politik –Partia Socialdemokrate (ish Vetëvendosje).

II.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.


Me Vendim njoftohen:

- E emruara në pikën I. Të Vendimit,
- MAPL, dhe
- Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.VII-2

Deçan,dt.29.06.2018





Ne bazë të nenit 46 të Kushtetutës së Kosovës, nenit 14, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 dhe në përputhje me nenin 6 dhe 10 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtëshme të Komunës, Rregullores së QRK-së Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Palujtëshme të Komunës, Ligjit mbi energjinë nr.03/L-184, nenit 21 të Statutit të Komunës së Deçanit, duke vendosur sipas kërkesë së Drejtoris për Urbanizëm dhe Planifikim Hapsinorë të dt.22.06.2018, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.06.2018, bie këtë:

VENDIM PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË (99) VITE TË TOKËS KOMUNALE

I.

I ipet në shfrytëzim afatgjatë (99) vite të tokës në pronësinë komunale pa kompensim material, përvës Tatimit në pronë, Kompanisë KEDS-sh.a, Divizioni i Shpërndarjes, për ndërtimin e, një pjesë e ngastrës kadastrale nr.436-0, nga certifikata: P-70505026-00436-0, me sipërfaqe (6.2 x 3.2) m (pronë shoqërore), Zona Kadastrale Dranoc.

II.

Në ngastrën e cekur më lartë me rastin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite pa kompensim parashihet ndërtimi i Stabilimentit Shpërndarës në fshatin Dranoc i furnizuar nga dalja 10(20) kV Juniku nga NS Deçani 110/10(20) kV, me qëllim të përfitimit publik.

III.

Me rastin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të një pjese të ngastrës nr. 436-0, marrësi i tokës në shfrytëzim duhet t'i përmbahet Planit Urbanistik.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi dhe për procedurat e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite kujdesen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtoria për MSH dhe SHP, sipas të gjitha Ligjeve në fuqi.

V.

Ky vendim miratohet në Kuvend me dt.29.06.2018, ndërsa implementimi i tij kushtëzohet me nënshkrimin e Kontratës në mes të Komunës së Deçanit dhe Kompanisë KEDS-sh.a. si bashkëinvestues në zhvillimin e projekteve të premtuara në sektorin e energjisë me interes për qytetarin.

VI.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen e Komunës.

VII.


Me nga një kopje të Vendimit do të paisen: Drejtoritë kompetente Komunale, Arkivi Komunal dhe Kompania KEDS-sh.a.


01.Nr.VII-7

Deçan, dt.29.06.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj





Në bazë të nenit 40.2 germa (e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 25 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit, në mbështetje të nenit 8 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.06.2018, bie këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E PANELIT PËRZGJEDHËS TË ANËTARËVE TË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË KOMUNËN E DEÇANIT

I.

Themelohet Paneli për zgjedhës i anëtarëve të Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuar në Komunën e Deçanit, në këtë përbërje:

1. Erdogan Dautaj –AAK nga Kuvendi, 2.Fatjeta Ramaj-AAK nga Kuvendi, 3.Besnik Hulaj-LDK nga Kuvendi, 4.Jashar Dobraj nga Ekzekutivi, 5.Safete Gacaferi nga OJQ.

Kryesuesi i Kuvendit e fton takimin e parë të Panelit, në të cilin takim Paneli e zgjedh kryesuesin, nga radhët e veta.

II.

Detyrë e Panelit për zgjedhës është: zhvillimi i procedurës së intervistimit të kandidatëve që konkurrojnë për anëtarë të Komitetit Konsultativ, sipas kritereve të përcaktuara me konkurs publik.

Pas përfundimit të procedurave të intervistimit, Paneli harton raportin dhe i propozon Kuvendit të Komunës për aprovim listën me anëtarë për Komitetin Konsultativ për personat me aftësi të kufizuar në Komunën e Deçanit.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Zyra e Kryetarit dhe Arhivi i Komunës.

01.Nr.VII-8/1

Deçan,dt.29.06.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

HYRESE-TILAZNA-INGOMG REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DECANI - DEÇANI MUNICIPALITY	
Nr. Prot. 19532	Br. Prot. 19532
Prot. No.	
Data:	
Mbiemri i kryesuesit:	



Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj